



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 480, datë 30.7.2021

P Ë R

**SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.404, DATË 30.6.2021, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT
PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË RRUGËVE "MIQËSIA"
DHE "AZEM HAJDARI - GJELBËRIMI", TË NDODHURA
BRENDA KONTURIT TË ZONËS SË RE PËR ZHVILLIMI, ZONA 4,
NJËSIA ADMINISTRATIVE DURRËS, BASHKIA DURRËS"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16, dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.404, datë 30.6.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit të rrugëve "Miqësia" dhe "Azem Hajdari - Gjellbërimi", të ndodhura brenda konturit të zonës së re për zhvillim, zona 4, Njësia Administrative Durrës, Bashkia Durrës".

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

**MINISTRI I SHETIT
PËR RINDËRTIMIN**


ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 3658/1
DATE 24. 8. 2021

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Engjëll AGAÇI', is written over a circular official stamp. The stamp is purple and contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRISË' at the top and 'KALLI I MËDHE' at the bottom, with a central emblem.